



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-16200 /23 datë: 30.06.2023



Npi – 01/269 datë: 04.07.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 04.07.2023, nxjerr këtë:

EKSTRAKT
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 04.07.2023 (e martë) në ora 14:00 h në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri, znj.Shkurte Mustafa, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: Përfaqësues nga UNMIK-u, z.Xhavit Fejza dhe z.Sreçko Bogajqeviq, dhe praktikantet znj.Valmira Hoxha, znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollor dhe regjistrimi i nxënësve,
2. Diskutime lidhur me punën e KPK në gjashtëmuorin e parë Janar-Qershor,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës, jemi në prag të pushimeve dhe rendi i ditës është i pranueshëm.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Informatë nga DKA për përfundimin e vitit shkollor dhe regjistrimi i nxënësve

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Nuk e kemi drejtoreshën prezent për të na informuar.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, po i prezantoj disa informata që i kemi, janë të regjistruar vetëm 6 nxënës të komunitetit pakicë, 3 janë parafillor dhe 3 në klasën e parë, në shkollën fillore në Shtime.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Fillimisht ekziston ligji ku fëmijët duhen të regjistrohen, fatkeqësisht informatë nga DKA-ja nuk kemi nëse DKA ka planifikuar për ndonjë fushatë për regjistrimin e fëmijëve me kohë sepse pa regjistrim në shtator konsiderojmë që nuk është mirë. Propozoj që ta bëjmë një rekomandim për DKA-në për të organizuar një fushatë në vendbanimet me Komunitete që së bashku

me organizatat tjera vendore e ndërkombtare të bëjnë fushatë për regjistrimin e fëmijëve në shkollat parafillore dhe fillorë.

* **Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i rekomandojë DKA-së, që së bashku me organizatat joqeveritare (OJQ) të organizojë fushatë për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore dhe ato fillore të gjitha komuniteteve, por në veçanti të komunitetit pakicë.**

Pika 2

Diskutime lidhur me punën e KPK në gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Pra se të hapi diskutimin për këtë pikë tha ne sot e kemi një raport që po prezantohen mbledhjet dhe rekomandimet që kemi marrë gjatë kësaj periudhe. E falenderojmë sekretarinë z.Idajet Rexhepin dhe praktikantet znj.Valmira Hoxha, e znj.Sadbere Halili për këtë raport të punuar ku shihet puna jonë gjashtë mujore.

z.Besnik Seferi; Pa përgjegjësia e drejtorëve për mospjesmarrjen në mbledhje po e zbehë rëndësinë e Komitetit në punën e tijë kjo është një vërejtje për drejtoritë përkatëse. Nuk e di se deri ku do të shkojmë. Ne edhe përkundër informatave të pakta për mungesë të drejtorive, ne kemi punuar edhe kemi nxjerrë rekomandime pothuajse mjaft shumë. Unë të përgëzoj për punën Kryesues, edhe anëtarët e Komitetit.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë ju falenderojë edhe juve asambleistëve që jeni pjesë e Komitetit që po i përcjellni rekomandimet në Kuvend.

z.Arton Demiri; I falënderoj të gjithë anëtarët e KPK-së për punën e bërë.

Pika 3

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Nëse diskutime nuk ka atëherë ju falenderojë për pjesmarrjen, pushime të mira për këtë vitë dhe po ashtu e falenderojë sekretarinë e Kuvendit z.Idajet Rexhepin për punën e bërë.

Meqenëse diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 14:31h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

